

Eppc Kosovë kërkon një *Teknik të Prodhimit* për klientin e saj e cila është një kompani vendore, **ndër më prestigjiozet në sektorin e mobilierisë që eksporton produkte enterieri edhe në Europë.**

### Përgjegjësitë Kryesore:

1. Merr porosinë saktë me te gjitha detajet e produktit nga blerësi;
2. Vendos të dhënat në software duke përfshirë dimensionet, ngjyrat, modelin etj;
3. Ndihmon në menaxhimin e produkteve dhe testimin të tyre para prodhimit;
4. Asiston në modifikimin e udhëzimeve të hollësishme të punës për prodhim përmes softwar-it;
5. Përgatit dokumentet e prodhimit që kanë të bëjnë me procedurat standarde të operimit;
6. Planifikon punët, zbaton politikat dhe procedurat si dhe rekomandon përmirësime të vazhdueshme.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë të përfunduar apo në përfundim të fakultetit Informatikë Inxhinierike, Makineri Industriale, Ndërtimtari, Elektroinxhinieri;
- Aftësi të mira të programeve kompjuterike;
- Aftësi për të punuar në ekip;
- Aftësi të mira të komunikimit verbal dhe përmes e-mailit;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Gatishmëria e punës jashtë orarit sipas nevojës.

### Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Teknik i Prodhimit;
<b>Vendndodhja:</b>	Mitrovicë/ Vushtrri;
<b>Orari:</b>	40 orë;
<b>Raporton tek:</b>	CEO;
<b>Udhëtime pune:</b>	Po, brenda vendit;
<b>Pagesa:</b>	Shumë e mirë (fikse + bonuse);
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	20 Prill.

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.